



Drejtuar: Operatorit Ekonomik "INERTI" shpk

Adresa: Lagjia Sporti, Gramsh

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: "Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Ali Demi"

Nr. References, REF 12021-03-04-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është "Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Ali Demi", sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

Fondi limit: 38.145.700,4 (tridhjetë e tetë milion e njëqind e dyzet e pesë mijë e shtatëqind presje katër) **lekë pa TVSH.**

Burimi i financimit: Të ardhurat e Bashkisë së Tiranës vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB Nr. 159, datë 21.12.2018 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2019 – 2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019, me objekt: "Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Ali Demi".

Kohëzgjatja e kontratës: Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve, 6(gjashtë) muaj.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 04.04.2019 , Ora: 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 10 datë 11.03.2019.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**
oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “BE IS” shpk me nr. NIPTI K71412003A

Çmimi total i ofertës = **35,690,425** (tridhjetë e pesë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e njëzetë e pesë) lekë pa TVSH.

2.Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Eurondertimi 2000 ”shpk, me nr. NIPTI K020030010

Çmimi total i ofertës = **27,471,351.55** (njëzetë e katër milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e një pikë tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

3.Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Inerti” shpk, me nr NIPTI J66926804L

Çmimi total i ofertës = **30,617,636** (tridhjetë milion e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

4.Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk me nr. NIPTI K67106202W

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **0 (zero) lekë**

5. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “Dajti Park 2007” shpk & “Glavenica” me nr. NIPTI K11507003S & K17710805A

Çmimi total i ofertës = **31,154,618** (tridhjetë e një milion e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH

6. Oferta e paraqitur nga Operatorit Ekonomik “Agi Kons” shpk me nr. NIPTI K21622001M

Çmimi total i ofertës pa tvsh= **34,345,076** (tridhjetë e katër milion e treqind e dyzetë e pesë mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

7. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Sireta 2F” shpk &”Varaku E” shpk, me nr. NIPTI K51501008J & J61902509S

Çmimi total i ofertës pa tvsh= **35,518,841** (tridhjetë e pesë milion e pesëqind e tetëmbëdhjetë

mijë e tetëqind e dyzetë e një) **lekë pa TVSH.**

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “Elda VI” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatorit Ekonomik “Eurondërtimi 2000 ”shpk

Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk është i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B, çka bie në kundërshtim me me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 14.

Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të DST: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)”* pasi nuk ka deklaruar në Shtojcën 10 mjetin elektroorgano.

Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të DST: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)”* pasi nuk ka deklaruar në Shtojcën 10 mjetin gazogjen.

Operatori ekonomik “Eurondërtimi” shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të DST: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)/ Eskavator me goma”* pasi mjeti eskavator me goma është deklaruar dhe paraqitur vetëm me fatura zhdoganimi dhe jo me dokumentacionin e kërkuar.

Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

3. Operatori Ekonomik “Agi Kons” shpk

Operatori ekonomik “Agi Kons” shpk nuk plotëson pikë 15 të Kapacitetit Teknik të

Dokumentave Standarte të tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10)/ Kamioçinë kapaciteti mbajtës 1.5 (një pikë pesë) deri në 2.5 (dy pikë pesë) ton/ 3 copë” pasi nuk ka deklaruar në shtojcën 10 mjetet kamioncinë.

Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Agi Kons” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

4.Operatori Ekonomik “BE-IS” shpk

Operatori ekonomik “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10)/ Eskavator me goma” pasi për mjetet eskavator me goma janë paraqitur vetëm me faturë tatimore dhe jo me dokumentacionin e kërkuar.

Operatori ekonomik “BE-IS” shpk nuk plotëson pikë 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10)/ Kamioçinë kapaciteti mbajtës 1.5 (një pikë pesë) deri në 2.5 (dy pikë pesë) ton” pasi janë deklaruar dhe paraqitur dokumentacion për mjete kamioncinë me targë AA079XJ me tonazh 1.3 Ton, kamioncina me targë AA108HK me tonazh 3.4, kamioncina me targë AA057NZ me tonazh 1 ton dhe kamioncina me targë VL8838C me tonazh 1.2 ton, pra asnjëra prej tyre nuk plotëson tonazhin e kërkuar. Gjithashtu për kamioncinën me targë VL8838 C nuk është paraqitur Çrtifikata për Transport Mallrash brenda Vendit cka bie në kundërshtim me gërmë “a” të kësaj pike: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontraten perkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes”.

Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “BE-IS” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 18.04.2019

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, **Operatorin Ekonomik “INERTI” shpk, me nr. NIPTI J66926804L, me adresë: Lagjja Sporti, Gramsh, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa tvsh = 30,617,636 (tridhjetë milion e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë,** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet , siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar

